

Drejtoria Rajonale Burrel
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Burrel, më ___ / ___ / 2023

PROCESVERBAL

PËR

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR - SHËRBIME” prokurim elektronik, – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të pronave, aseteve dhe personelit të OSSH Sh.A dhe të Njesisë Kordinimit Burrel FSHU Sh.A”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79713000-5 Shërbime roje/ shërbime me roje

VLERA E FONDIT LIMIT:

64,512,541.27 (gjashtëdhjetë e katër milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e një pikë njëzet e shtatë) **lekë pa TVSH.**

607,634.37 (gjashtëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) **euro pa TVSH, (1 EU - 106.17 lekë)** referuar kursit të këmbimit ditor, **datë 25.09.2023** të Bankës së Shqipërisë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria Rajonale e OSSH, Burrel** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

SHËNIM: Operatorët ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit të publikuar në DST duhet të paraqesë edhe:

- Analizën e Çmimit me përllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:
 - Shpenzime për pagë bazë,
 - Shtesë mbi pagë për turnin II,
 - Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
 - Shpenzimet për blerjen dhe vendosjen e paisjeve për verifikim sinjal alarmi
 - Shpenzime për ndërlidhje,
 - Fitimi i shoqërisë.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizës së kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t'u kërkojë operatorëve ekonomikë sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta skualifikojë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Gjithashtu, bazuar në parashikimet e nenit **80** pika **2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” dhe **nenit 41 pika 5/ç** dhe **6** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (të ndryshuar), referuar specifikës që ka ky shërbim në lidhje me përllogaritjen e kostos në ofertën që do paraqesin operatorët ekonomikë, ku shumica e zërave që do të përllogariten janë të sanksionuara në akte ligjore dhe nënligjore si kosto ligjore, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës, krahas **Formularit të Ofertës** sipas *Shtojcës 1* në DST, duhet të paraqesin dhe **preventivat e përllogaritjes së kostos mujore** (sipas preventivave në DST) e cila i shërben autoritetit kontraktor në lidhje me përllogaritjen e vlerave sipas afateve për kontratat që do të lidhë në zbatim të marrëveshjes kuadër, si dhe **analizën e përllogaritjes së çmimit** me përllogaritjet konkrete aritmetike, me qëllim kontrollin dhe verifikimin nëse në çmimin e ofertuar janë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore të cituara, pasi në rast të kundërt, do të procedohet me s'kualifikimin e ofertave të tyre.

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin e mësipërm pasi oferta e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të jetë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas.

2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- 2.1.1 Liçensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.A**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike dhe transport vlerash monetare”, lëshuar nga QKL/ QKB;
- 2.1.2 Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për **nënkategorinë 1.3.A** i pajisur edhe me çertifikatë trajnimi për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit.
- 2.1.3 Operatori ekonomik të disponojë Nipt Kryesor në qytetin Peshkopi dhe Lezhë për operatorët që kanë selinë kryesore në këtë qytet dhe Nipt Sekondar për operatorët që kanë selinë kryesore në një vendodhje tjetër.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1, 2 dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale**;... **c) aftësinë teknike dhe profesionale**;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me **aftësitë teknike dhe profesionale**, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se,

Drejtoria Rajonale Burrel
NJËSIA E PROKURIMIT

1. Referuar natyrës së shërbimit objekt prokurimi, ai i ruajtjes dhe sigurisë fizike të pronave, asetëve dhe personelit të “OSSH” Sh.A dhe të Njesisë Koordinimit Burrel “FSHU” Sh.A, bazuar në ligjin nr. **75/2014** “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, në të cilin përcaktohet se, **neni 6 “Liçencimi” - 1. Licencimi i subjekteve të SHPSF-ve bëhet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktura në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; neni 7 “Kategoritë e Liçencës”, “Licencat, sipas këtij ligji, ndahen në dy nënkategori:... b) nënkategoria I.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit”; neni 9 “Llojet e çertifikatave”, “Çertifikatat për titullarin e SHPSF-së, për drejtuesin teknik dhe për punonjësin e shërbimit ndahen në lloje, sipas nënkategorive të licencës.” dhe Kreut I/A të Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë liçensën profesionale për ushtrimin e veprimtarisë objekt prokurimi, si dhe nënkategorinë e kërkuar (1.3.A) të përcaktuar në përputhje me natyrën e shërbimit objekt prokurimi, atë të sigurimit fizik të objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike**, e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit. Në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar dokumentacionin në mbështetje të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” për vërtetimin se op. ek. pjesëmarrës disponon liçencën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit objekt prokurimi.**
2. Referuar parashikimeve të nenit 9 të ligjit nr. **75/2014** “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, ku është e detyrueshme dhe çertifikimi i drejtuesit teknik të subjektit sipas nënkategorisë së liçencës, njësia e prokurimit vlerëson të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin dhe çertifikatën e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për **nënkategorinë 1.3.A**. Gjithashtu, duke qënë se Drejtuesi Teknik i SHPSF-së, është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë, dhe është personi i cili *përgjigjet për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e kryerjes së shërbimit nga punonjësit e SHPSF-së, dhe planifikon shërbimet për ruajtjen e objektit dhe personelit sipas parashikimeve në pikën 3 dhe 5 të Kreut V të Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, dhe detyrimit ligjor që ka punëdhënësi për marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 4 dhe 7 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), njësia e prokurimit*

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

vlerëson se, drejtuesi teknik i shoqërisë duhet që të jetë i pajisur me çertifikatë trajnimi për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, **me qëllim identifikimin e risqeve potenciale që ndikojnë në shëndetin e punonjësve, marrjen e masave për parandalimin e dëmtimeve në shëndet, dhe zbatimin e programeve që garantojnë sigurinë në punë të tyre.**

3. Po ashtu, referuar specifikës së shërbimit objekt prokurimi, ku operatorët ekonomik duhet që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun Dibër dhe Lezhë, pasi kanë të instaluar qendrën e kontrollit, grupin e gatshëm etj., për vërtetimin se ato ushtrojnë aktivitet në këto qarqe ku kërkohet kryerja e shërbimit objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson të përfshijë kërkesën për disponimin e niptit kryesor për ato op. ek. pjesëmarrës që kanë selinë kryesore në këto qytete dhe niptit sekondar për ato që nuk e kanë, kërkesë kjo, bazuar në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 62 paragrafi 2 e tij, ku në dokumentin, Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit, përcaktohet *selia apo zyra qendrore e shoqërisë si edhe vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit*, sipas të cilave vërtetohet se në cilat qytete ushtron veprimtarinë e tij operatori ekonomik pjesëmarrës.

Njësia e prokurimit përcaktoj kërkesën si më lart, duke qënë se është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre (*besueshmërinë*) për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (*një*) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit
- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. **Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare...”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;**

3. **Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Drejtoria Rajonale Burrel NJËSIA E PROKURIMIT

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujtuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh ekonomik, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë akt – marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik, si dhe në rast se është realizuar si nënkontraktor duhet të paraqesë miratimin e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që**

Drejtoria Rajonale Burrel NJËSIA E PROKURIMIT

operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se krahas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 41 të VKM-së, kur shërbimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të paraqitet dhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **45 (dyzet e pesë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku të përfshihet edhe Drejtuesi Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues, duhet që në stafin teknik të ketë edhe **1 (një)** punonjës i diplomuar për *Elektronik/ Telekomunikacioni/ Informatik*, i trajnuar dhe i çertifikuar nga një prej prodhuesve të sistemeve elektronike për të instaluar dhe mirëmbajtur këto sisteme elektronike, me qëllim mirëmbajtjen e sistemit elektronik të sallës operative. Për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Diplomë, Çertifikatë e trajnimit nga Prodhuesi, Kontratën e Punës e cila duhet të mbulojë të gjithë periudhën e shërbimit, si dhe të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2. *Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim.*

2.3.4 Me qëllim kryerjen e instalimit të sistemeve të alarmit në godinat e Drejtorisë Rajonale OSSH Sh.a Burrel, sipas specifikimeve teknike, pasqyruar në DST, operatori ekonomik ofertues duhet që në stafin e tij të ketë:

- Minimumi **1 (një)** Inxhinier Elektrik ose Elektriçist (në rast se nuk disponon inxhinier) për të cilët duhet të paraqesë diplomën përkatëse të shkollës së lartë ose të mesme, çertifikatën për kualifikim të sigurimit teknik, si dhe *të figurojë minimalisht në listpagesë të shoqërisë* për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2
- Minimumi **1 (një)** Inxhinier Ndërtimi ose Teknik Ndërtimi (në rast se nuk disponon inxhinier) për punime ndërtimore në rast të dëmtimit të suvasë, hapje kanali, dëmtim boje, etj. gjatë montimit të kamerave dhe sinjal alarmin, për të cilët duhet të paraqesë diplomën përkatëse të shkollës së lartë ose të mesme, çertifikatë për kualifikim të sigurimit teknik, *të figurojë minimalisht në listpagesë të shoqërisë* për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2

Disponimi i stafit inxhinierik/ punonjësve të kualifikuar do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Drejtoria Rajonale Burrel NJËSIA E PROKURIMIT

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.5 Me qëllim parandalimin e zjarreve dhe trajnimin e punonjësve të shërbimit, për shkak se: - *Ka rrezikshmëri të shtuar ndaj zjarrit si rezultat i pranisë të rrymës elektrike në mjediset e nënstacionit me rrezikshmëri të lartë, vlera monetare në KNK, Arka etj, - Magazina me mallra të ndryshëm etj. Janë objekte me vendndodhje në zona me objekte të shumta e të dendura banimi, operatori ekonomik ofertues duhet që në stafin e tij të ketë 1 (një) Ekspert privat Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”.*

Për të përmbushur këtë, operatori ekonomik duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Liçencë kodit I.2A të lëshuar nga QKL/QKB, Kontrat Pune, Leje për ushtrimin e profesionit lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Drejtoria e PMNZSH, si dhe të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2.

Për operatorët ekonomik që nuk kanë në staf Ekspertin, duhet të paraqesin:

- *Kontratë shërbimi nënshkruar me Ekspertin të liçencuar për këtë lloj shërbimi;*
- *Liçencë kodit I.2A të lëshuar nga QKL ose QBK,*
- *Leje për ushtrimin e profesionit lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Drejtoria e PMNZSH*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili prej operatorëve ekonomik në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** pika **1** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. **Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç**

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/b** dhe **c** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriterë janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriterë detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej **45 (dyzet e pesë) punonjës**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 41 pika 4/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e stafit teknik dhe punonjësve të shërbimit që nevojitet për realizimin e shërbimit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 7 “*Termet e Referencës*” dhe llojit të shërbimeve që do të kryhen, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre)

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuuese.

- Referuar rëndësisë që paraqesin pajisjet elektronike të instaluar në sallën operative, dhe sistemet e radiokomunikimit, sistemet e radioalarmit e të kamerave të instaluar në ambientet dhe godinat e “OSSH” Sh.A., dhe “FSHU” Sh.A., ku kërkohet të kryhet shërbimi objekt kontrate, pasi pa këto pajisje/sisteme nuk do të garantohej siguria e plotë e ruajtjes dhe sigurisë fizike të pronave, asetëve dhe personelit, me qëllim mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e tyre, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë **1 (një)** punonjës të diplomuar për *Elektronik/ Telekomunikacioni/ Informatik*, i trajnuar dhe i certifikuar nga një prej prodhuesve të sistemeve elektronike, kërkesë kjo në përputhje dhe me përcaktimet e Kreut VII/D të Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “*Për funksionimin e Shërbimit Provat të Sigurisë Fizike*” në lidhje me detyrat e rëndësishme që kryen qendra e kontrollit e cila duhet të jetë funksionale në çdo moment, ku për vërtetimin e disponimit të tij duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë organizative, besueshmërisë si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.
- Po ashtu, referuar natyrës së kontratës objekt prokurimi, ku kërkohet kryerja e punimeve për instalimin e sistemeve të alarmit në ambientet e godinave të Drejtorisë Rajonale OSSH Sh.a Burrel dhe “FSHU” Sh.A., duke qënë se për instalimin e tyre do të kryhen ndërhyrje në muret dhe fasadat e godinave ku do të vendosen këto sisteme alarmi, me qëllim kryerjen e këtyre ndërhyrjeve në zbatim të kushteve teknike të ndërtimit dhe shmangien e dëmtimeve nga ana strukturore, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi **1 (një)** Inxhinier Ndërtimi ose Teknik Ndërtimi (në rast se nuk disponon inxhinier) për kryerjen dhe ndjekjen e punimeve ndërtimore që do të kryhen si: *hapje kanali, suva, lysterje etj.* Gjithashtu, duke qënë se këto sisteme për funksionimin e tyre do të lidhen me instalimet elektrike që janë në këto godina, me qëllim lidhjen e tyre komform rregullave teknike dhe shmangien e ndonjë avarie në linjat elektrike të instaluar, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë minimumi **1 (një)** Inxhinier Elektrik ose Elektriçist (në rast se nuk disponon inxhinier) për kryerjen dhe ndjekjen e lidhjeve të energjisë elektrike. Kërkesa specifike për inxhinierët/ punonjësit e specializuar të kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë natyrës së shërbimeve objekt kontrate, ku operatorët ekonomikë duhet të **vërtetojnë se disponojnë personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar.
- Gjithashtu, referuar veprimtarisë që ushtrohet në këto objekte (*zyra, magazina, KNK, Arka*) ku kërkohet të kryhet shërbimi, gjendet personeli, asetet, vlera monetare, si dhe faktit ku këto objekte janë me vendndodhje në zona të banuara, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë duhet të disponojnë në stafin e tyre, ose të kontraktuar **1 (një)** specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin. Kjo kërkesë është në përputhje

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në të cilin përcaktohet se, **personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktim-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.**

Stafi teknik (drejtuesit, specialistët) i kualifikuar dhe punonjësit e shërbimit i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të zotërojë Liçencë/ Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi Qarkun Dibër dhe Qarkun Lezhë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se muaji **Maj 2023**, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së **Qarkut Dibër**, me anë të cilit të jepet *informacion* për:

- Jo më pak se **1 (një)** përgjegjës shërbimi,
- Jo më pak se **20 (njëzet)** punonjës shërbimi,
- Grup të gatshëm 24 orë
- Qendër Kontrolli në qytetin Peshkopi (*Sallë Operative*),
- Jo më pak se **8 (tetë)** objekte nën ruajtje sipas objektit të prokurimit,
- Nuk janë dhënë masa administrative për vitet 2021-2022,
- Ka punuar mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se muaji **Maj 2023**, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së **Qarkut Lezhë**, me anë të cilit të jepet *informacion* për:

- Jo më pak se **1 (një)** përgjegjës shërbimi,
- Jo më pak se **15 (pesëmbëdhjetë)** punonjës shërbimi,
- Jo më pak se **4 (katër)** operatorë të Qendrës së Kontrollit
- Jo më pak se **1 (një)** grup për verifikimin e sinjaleve me jo më pak se **4 (katër)** punonjës
- Qendër Kontrolli në qytetin Lezhë (*Sallë Operative*),

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

- Jo më pak se **8** (*tetë*) objekte nën ruajtje sipas objektit të prokurimit,
- Nuk janë dhënë masa administrative për vitet 2021-2022,
- Ka punuar mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt-Miratim për Qendrën e kontrollit në qytetin e Peshkopisë dhe Lezhës të vlefshme në datën e hapjes së tenderit, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër dhe Lezhë në përputhje me Kreu VII, pika 5, i Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale.** **Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.** 4. Në lidhje me **aftësitë teknike dhe profesionale**, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 2, 4 dhe 6** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” b) një listë të

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere, janë kritere detyruese edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për zotërimin e Licensës/ Autorizimit për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga **AKEP**, me zonë mbulimi **Qarkun Dibër dhe Qarkun Lezhë**, është vendosur duke iu referuar natyrës së funksionimit të shërbimit dhe vendodhjes së objekteve për të cilat kërkohen shërbimi i ruajtjes, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi, **nenit 22 dhe 32** të ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Neni 22 “Qendra e kontrollit të SHPSF-së” - 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike... 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë. Neni 32 “Pajisjet për shërbimin e sigurinë private” **1. Subjektet e licencuara janë të detyruara të përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike...**” dhe Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” **Kreun VII “Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të SHPSF-së”, gërma D “Qendra e kontrollit” pika 4, në të cilin përcaktohet se: “4. Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike që ka në ruajtje objekte me sisteme elektronike, duhet pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual.”**, ku me qëllim garantimin e funksionimit të mjeteve të ndërlidhjes të cilat shërbejnë për zbatimin e shërbimit objekt kontrate, operatori ekonomik duhet të zotërojë liçencën/autorizimin e lëshuar nga organi kompetent.
2. Referuar natyrës dhe specifikës së shërbimit objekt kontrate, me qëllim vërtetimin se operatorët ekonomik pjesëmarrës disponojnë kapacitetet e nevojshme të **punonjësve, pajisjeve, si dhe një performancë të mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit** për sa i përket masave administrative dhe shkeljet e konstatuara, duke qënë se veprimtaria e shoqërive të ruajtjes dhe sigurisë fizike (SHPSF) mbikqyret dhe kontrollohet nga struktura përkatëse e policisë së shtetit, në zbatim të parashikimeve të nenit 24 të ligjit nr. **75/2014** “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ku përcaktohet se: “Titullari i SHPSF-së është përfaqësuesi ligjor i subjektit të licencuar që ofron

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

shërbimin për sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike, si dhe për sigurimin e vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, të kontraktuara, dhe ka këto përgjegjësi:... e) të informojë, me shkrim, të paktën një herë në muaj, në strukturën përkatëse të Policisë të Shtetit, për veprimtarinë e SHPSF-së;” dhe Kreut V gërma A dhe B të Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” ku përcaktohet se, citojmë: “11. Veprimtaria e SHPSF-së realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit me: a) roje objekti për ruajtjen fizike; ... d) punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit; e) punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike; f) përgjegjës shërbimi; ...; “B1. Veprimtaria e SHPSF-së mbikëqyret dhe kontrollohet periodikisht nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit.”, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetimin e performancës me të dhënat e kërkuara nga Drejtoritë e Policës së Qarkut Dibër dhe Lezhë, referuar vendodhjes ku kërkohet të shërbimi objekt kontrate.

- Gjithashtu, në lidhje me kryerjen e shërbimit që kërkohet objekt kontrate, për shkak të rëndësisë që paraqet shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të pronave, aseteve dhe personelit të OSSH Sh.A dhe të Njësisë Koordinimit Burrel FSHU Sh.A, **me qëllim komunikimin me punonjësit e shërbimit, grupin e gatshëm për ndërhyrje në raste emergjente, si dhe funksionimin/verifikimin e sistemeve të alarmit gjatë kryerjes së shërbimit objekt kontrate**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë qendër kontrolli në qytetet kryesore të qarqeve ku do të kryhet shërbimi, ku për vërtetimin e tyre duhet të paraqesin akt – miratimet për këto qendra. Kjo kërkesë bazohet në parashikimet e **nenit 22** të ligjit nr. **75/2014** “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ku përcaktohet se: “1. **Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë. 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike. 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë.**”, dhe Kreut VII, gërma D dhe E të Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” ku përcaktohet se, citojmë: “D/5. **Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve. E/1. Qendra e Kontrollit kryen detyra për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e shërbimeve të SHPSF-së, për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike dhe sigurimin e vlerave monetare dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.**” Njësia e Prokurimit vlerëson se, një operator ekonomik pa disponimin e këtyre qendrave të kontrollit nuk mund të marrë përsipër kryerjen e shërbimit objekt kontrate.

Drejtoria Rajonale Burrel
NJËSIA E PROKURIMIT

Kriteret e mësipërme janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në proporcion me nevojat për realizimin e shërbimit me sukses, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht **5 (pesë) automjete** dhe **2 (dy) motorra** në emër të shoqërisë, ose të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ku të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për automjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- *Lejet e qarkullimit.*
- *Çertifikatë e kontrollit Teknik*
- *Taksat e paguara.*
- *Siguracionet*

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- *Kontratë qeraje noteriale*
- *Çertifikatat e Pronësisë*
- *Lejet e qarkullimit.*
- *Çertifikatë e kontrollit Teknik*
- *Taksat e paguara.*
- *Siguracionet*
- *Faturat tatimore të prera nga qiradhënësi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera*

Disponimi i automjeteve/ motorrave do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë **15 (pesëmbëdhjetë) armë brezi** dhe **10 (dhjetë) armë krahu**, kategoria 1.3.A ku të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm.

- *Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;*
- *Kontratë Shitblerje*
- *Fatura Shitblerje.*
- *Pagesën bankare*

Disponimi i armëve të brezit dhe armëve të krahut do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet,

Drejtoria Rajonale Burrel NJËSIA E PROKURIMIT

përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.** 4. Në lidhje me **aftësitë teknike dhe profesionale**, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 41** “Kërkesat të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/ç dhe 6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:..., ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret, janë kriteret detyruese edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

1. Kriteri për disponimin e **automjeteve dhe motorrave** është vendosur bazuar në natyrën e shërbimit objekt prokurimi, ku kërkohet ruajtja fizike e pronave, asetëve dhe personelit, ku lind

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

e nevojshme disponimi i automjeteve/ motorrave. Këto mjete dhe motorra janë kërkuar duke patur parasysh faktin se, u shërbejnë për transportin e punonjësve të shërbimit në vendrojet ku do të kryhen shërbimet, kryerjen e verifikimit të sistemeve të alarmit, si dhe lëvizjen e grupeve të gatshme në raste të ndërhyrjeve në situata emergjente, ku numri i kërkuar i tyre është minimal referuar numrit të punonjësve të shërbimit që do të angazhohen, specifikës së shërbimit dhe duke patur parasysh shtrirjen territoriale të objekteve të OSSH-së dhe FSHU-së referuar largësisë së shpërndarjes së tyre, përkatësisht në **Qarkun Dibër**, në qytetet: Peshkopi (Maqellarë, Kastriot), Bulqizë (Shupenzë), Klos, Burrel dhe **Qarkun Lezhë**, në qytetet: Laç (Mamurras), Milot, Rrëshen (Rubik), pasi pa këto automjete dhe motorra nuk mund të kryhet shërbimi i ruajtjes, ku si rrjedhojë mund të çenohet siguria e pronave, aseteve dhe e personelit të OSSH-së dhe FSHU-së, Drejtoria Rajonale Burrel.

2. Në lidhje me **armët e kërkuar**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë numrin e **armëve të brezit** të kërkuar referuar numrit të vendrojeve (*objekteve*) në të cilat do të ofrohet shërbimi me roje dhe rëndësinë që ka ruajtja e këtyre objekteve (personeli, vlerat monetare në to etj), si dhe duke qënë se shërbimi i rojeve kërkohet edhe për objekte të rëndësisë së veçantë, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme që operatori ekonomik të disponojë dhe **armë krahu**, ku për vërtetimin e këtyre armëve operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor e kërkuar. Kërkesa këto në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe në mbështetjeve të akteve ligjore dhe nënligjore, ku më hollësisht, në ligjin nr. **75/2014** “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, **neni 27, pika “c”** i tij, parashikon se: “...punonjësi i shërbimit ka përgjegjësi të mbajtje, sipas rregullores, **armatimin personal e pajisjet e shërbimit**, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës si dhe të përdorë **armën sipas legjislacionit në fuqi**.”, ndërsa në nenin **34**, përcaktohet se, citojmë: “1. Në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit. 2. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje, miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi”, ku në Urdhërin Nr.1491, datë 21.06.2001 të Ministrit të Rendit Publik “Për pajisjen e shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike me armatim, municion dhe mjete speciale”, (i ndryshuar me Urdhërin nr.155, datë 29.05.2014), përcaktohet se: “2. Pajisjen me pistoletë **TT.Mod.54 e 14 fishekë**: a) Punonjësi i shërbimit të shoqërisë që bën ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve publike dhe private; b) Punonjësi i shërbimit të shoqërisë private që bën sigurimin fizik, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj. 3. Pajisjen me automatik mod. **56 me 30 fishekë**: a) Punonjësi i shërbimit të shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike që bën ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve depot e lëndëve plasëse për përdorim civil, HEC (hidrocentralet), depo uji, **nënstacione elektrike, godinave të SHISH-it...**”, ku për vërtetimin e disponimit të tyre, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin autorizimin për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në zbatim të parashikimeve ligjin nr.74/2014 “Për Armët”

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

Kreu **IV** “E drejta dhe kriteret e mbajtjes së armës” **neni 24** “Llojet e autorizimeve”, **pika 1**, përcaktohet se: “Në kuptim të këtij ligji, autorizimet që lëshon organi përgjegjës i Policisë së Shtetit janë: **a) autorizim për blerje arme;**”, ndërsa në nenin **25** “Autorizimi për blerje arme zjarri për personat juridikë” parashikon se: “Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për blerje arme zjarri të kategorive “B1”, “B4” dhe “C”, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, këta persona juridikë: **a) subjektet e licencuara për shërbimin e sigurisë private**, si dhe dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e blerjes së tyre.

Njësia vendosi të kërkoj mjetet e mësipërme sepse ato kane lidhje te ngushtë me objektin e kontratës dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Njësia vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizoj shërbimin e parashikuar në këtë prokurim.

2.3.12 Me qëllim funksionimin e Sallave Operative **24 orë në 24 orë** pa ndërprerje, Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht **2 (dy)** gjenerator rezervë me jo më pak se 30 KWA, me qëllim furnizimin e sallave me energji në rast ndërprerje të saj.

Në rast se gjeneratorët janë **në pronësi**, operatori duhet të paraqesë:

- *Fatura Tatimore Shitje, dhe/ose*
- *Kontratë Shitblerje, dhe/ ose*
- *Kontratë Dhurimi, dhe/ose*
- *Deklaratat zhdoganimi për të gjitha rastet duhet të paraqitet dhe fatuara e pagesës për sendin, duke përjashtuar rastin e dhurimit.*

Në rast se gjeneratorët **nuk janë në pronësi**, operatori duhet të paraqesë:

- *Kontrata e lidhur përpara noterit për marrjen në përdorim të sendit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.*
- *Fatura Tatimore të Shit-blerjes së sendit, dhe/ose*
- *Deklaratën e zhdoganimit.*

- Për operatorët ekonomik që nuk disponojnë gjenerator, duhet të paraqesin Bateri dhe/ose UPS që garantojnë furnizimin me energji të Qendrës së Kontrollit për jo më pak se 12 orë në përputhje me nenin 22 të ligjit Nr.75/2014. Për të përmbushur këtë kriter, operatorët duhet të paraqesin:

Në rastet kur pajisja është **në pronësi**, operatori duhet të paraqesë:

- *Fatura Tatimore Shitje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji dhe/ose*
- *Kontratë Shitblerje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji dhe/ose*
- *Deklarat Zhdoganimi e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji*
- *Për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës për sendin.*

Në rastet kur pajisja **nuk është në pronësi**, të paraqitet:

Drejtoria Rajonale Burrel NJËSIA E PROKURIMIT

- *Kontrata e lidhur përpara Noterit për marrjen në përdorim të sendit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji.*
- *Faturën tatimore të shitblerjes së sendit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose*
- *Deklaratën e zhdoganimit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji.*

Disponimi i pajisjeve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Autoriteti rezervon të drejtën e verifikimit të sallës dhe në rast se kostaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht kapacitetin, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili prej operatorëve ekonomik në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim.

2.3.13 Me qëllim realizimin e shërbimit në përputhje me Udhëzimin nr.130 datë 5.3.2018 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike" të Ministrit të Brendshëm dhe parandalimin e veprimeve kriminale, OE duhet të disponojë jo më pak se **16** (gjashtëmbëdhjetë) dedektorë dore elektronike, jo më pak se **16** (gjashtëmbëdhjetë) spray neuroparalizues, jo më pak se **16** (gjashtëmbëdhjetë) radio komunikimi dhe jo më pak se **16** (gjashtëmbëdhjetë) copë jelek antiplumb.

Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë:

- *Faturë Tatimore e Shitjes e firmosur nga të dyja palët dhe e vulosur nga shitësi;*
- *Pagesën që vërteton vlerën e blerjes së paisjeve;*
- *Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;*

Në rastet kur këto kapacitete janë blerë jashtë vendit operatori duhet të paraqesë:

- *Deklaratën e zhdoganimit nëpërmjet së cilës vërtetohet zhdoganimi i paisjeve;*
- *Xhirimin Bankar që vërteton pagesën e vlerës së blerjes së paisjeve;*
- *Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;*

Disponimi i pajisjeve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Autoriteti rezervon të drejtën e verifikimit të sallës dhe në rast se kostaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht kapacitetin, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përbën kusht s'kualifikimi.

- 2.3.14 Operatori duhet të disponojë jo më pak se **2 (dy)** Sistem Radiokomunikimi, jo më pak se **2 (dy)** Sistem Radiolarmi dhe jo më pak se **2 (dy)** Sistem Kamerash në distancë të vërtetuar me fatura tatimore, pagesat përkatëse dhe deklarimin e faturave në sistemin elektronik të tatimeve.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

Në **nenin 41** “Kërkesat të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/ç** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:..., ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere, janë kritere detyruese edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

1. Nisur nga kushti i parashikuar në dispozitën e **nenit 22 pika 3** të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ku përcaktohet se: “3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë.”, dhe **Kreut VII, gërma E, pika 8** e Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, në të cilin përcaktohet se: “8. Shërbimi në Qendrën e Kontrollit kryhet nga punonjës shërbimi (operator) pa ndërprerje, gjatë 24 orëve, me tre turne.”, si dhe referuar specifikës së ligjit për funksionimin e Qendrës së Kontrollit e cila duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë nga një gjenerator për secilën qendër kontrolli, ose në mungesë të tij Bateri dhe/ose UPS që garantojnë funizimin me energji të Qendrës së Kontrollit për jo më pak se 12 orë për çdo salle, pasi është domosdoeshmëri që shërbimi në qendrën e kontrollit të funksionojë pa ndërprerje 24 orë, kërkesë kjo në funksion të realizimit me sukses të kontratës.
2. Po ashtu, njësia e prokurimit duke patur parasysh numrin e objekteve në të cilat do të ofrohet shërbimi me roje dhe rëndësinë që ka ruajtja e këtyre objekteve (personeli, asetet, vlerat monetare në to etj.) gjykon se, **pajisja e rojeve me dedektor dore elektronik, spray neuroparalizes, radio dore dhe Jelek Antiplumb** është e nevojshme për parandalimin e veprimeve kriminale që mund të kryhen (ku nga përvojat e kaluara, kemi patur shumë ndodhi të tilla fatkeqsisht), për këtë arsye vendosi t'u kërkojë operatorëve ekonomik të disponojnë pajisje e kërkuara, kërkesë e cila është vendosur në përputhje të plotë me **Kreun VII “Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të SHPSF-së”, gërma B “Mjetet dhe pajisjet e shërbimit” pika 3** të Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, përcaktohet se: “3. Shoqëria private e sigurisë fizike, për realizimin e detyrës, në varësi me specifikat e shërbimit pajis punonjësit me: a) armatim personal, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për armët”; b) pistoleta elektrike; c) bodygard spray; d) jelek antiplumb; e) hekura lidhës; f) shkop gome; g) elektrik dore; h) radio ndërlidhjeje; i) detektor dore; j) maskë gazi; k) dylbi; l) helmetë; m) rrip multifunksional.” Njësia vendosi të kërkoj pajisjet e mësipërme sepse ato kane lidhje të ngushtë me objektin e kontratës dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.
3. Referuar numrit të qendrave të kontrollit të kërkuar si dhe referuar specifikës së ligjit për funksionimin e Qendrës së Kontrollit e cila duhet të jetë e pajisur me sistem ndërlidhjes e komunikimit, radioalarmit dhe kamerave, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë nga dy sistem radiokomunikimi, dy sistem radiolarmi dhe dy sistem kamerash për secilën qendër kontrolli, kërkesë kjo bazuar në **nenin 32** të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ku përcaktohet se: “1. Subjektet e licencuara

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

janë të detyruara të përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike.”, dhe në përcaktimet e Udhëzimit Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” **Kreu VII, gërma D, pika 1 dhe 2** i tij, ku parashikohet se, citojmë: “2. Qendra e Kontrollit pajiset me sistem ndërlidhës telefonik (mobile e fiks) dhe radiokomunikim, të cilat bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të komunikimit pranë çdo objekti në ruajtje. 3. Serveri bazë duhet të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL dhe ruajtjes së sinjalit video.” si dhe **gërma E, pika 3**, në të cilin përcaktohet: “3. Qendra e Kontrollit realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimin në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrjen dhe verifikimin e sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) nëpërmjet komunikimit me pajisjet në përdorim: - telefon celular (GSM); - telefon fiks (Kontakt ID); - radio.”

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor, për vërtetimin se operatorët ekonomik pjesëmarrës disponojnë aftësitë e duhura organizative dhe kapacitetet e nevojshme teknike për të zbatuar kontratën, pasi në mungesë të tyre, nuk do mund të kryhej shërbimi objekt kontrate, si dhe nuk do të garantohej shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të pronave, aseteve dhe personelit, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën Nr.Prot.426, datë 04.07.2023 “Relacion në lidhje me nevojën për shërbimin privat të sigurisë dhe sigurisë fizike” dërguar nga Dega e Shërbimeve/ Drejtoria Rajonale OSSH Sh.a., Burrel, në të cilin gjendet grafiku i shërbimeve që kërkohen, dhe Proçesverbalit “Për përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike...” të Komisionit të Posaçëm në të cilin janë hartuar Specifikimet Teknike e Termat e Referencës për shërbimin objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 41 pika 1 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

Drejtoria Rajonale Burrel

NJËSIA E PROKURIMIT

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**
- **Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë data 26.10.2023, ora 10.⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT